



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta	
Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref.Nr.	4040/2023
Data	11.08.2023
Çështja	
Signature	
PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINE	

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /  
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit

Kabinet Ministra

Minister's Office

Nr.145/2023

Datë: 11.08.2023

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 08/L -117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh neni 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe pikën 8 (tetë) të Shtojcës 1 (një) të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgimi Kulturor, Rregulloren NR. 11/2022 Për Inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi me numër të protokollit 3639/2023 i datës 14.07.2023 i Komisionit Profesional Shqyrtues i kërkesave - propozimeve të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, aseteve apo përmbajtjeve me forma të shprehjes kulturorë - Kategoria e Trashëgimisë Shpirtërore “Ansamblin Kulturor - Artistik Bajram Curri - Prishinë”.
2. Obligohet QRTK- Prishtinë që asetin sipas pikës 1 të dispozitivitetit të këtij vendimi ta regjistrojë në databazë, t’i japë numrin unik, ta kategorizojë sipas Ligjit në fuqi dhe ta përfshijë në Listën e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje të Përkohshme, në kategorinë e Trashëgimisë Shpirtërore.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Kërkesën për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme të “Ansambli Kulturo-Artistik Bajram Curri” e ka parashtruar në vitin 2020. Propozimi është dërguar nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore (DTK) në prill 2023 në MKK për t’u shqyrtuar tutje në Komisionin Profesional Shqyrtues (KPSH) i Muzeut Kombëtar të Kosovës (MKK).

KPSH në MKK e ka dhënë rekomandimin që “Ansambli Kulturo-Artistik Bajram Curri – Prishtinë” të përfshihet në listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme në kuadër të kategorisë Trashëgimi Shpirtërore.

Komisioni Profesional Shqyrtues i DTK pas shqyrtimit të lëndës, formularit të inventarizimit të punuar nga KPSH i MKK, dhe rekomandimit të tij, e rekomandon për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme “Ansambli Kulturo-Artistik Bajram Curri” për arsye se i përmban këto vlera:

### **Vlerë historike**

Është themeluar qysh në vitin 1965 dhe është një prej Ansambleve më të vjetra;

### **Vlerë të rarisetit**

Veprimtaria e Ansamblit ka vazhdimësi të veprimtarisë deri më sot, po ashtu edhe të formave të shprehjes kulturore të traditave popullore;

### **Vlerë artistike**

Është Ansambël i cili i ka promovuar këngët, vallet autentike, dramat, grupin letrat, veshjet tradicionale, instrumentet tradicionale, lojërat, ritet burimore;

### **Vlerë shoqërore**

Për arsye se që nga koha e themelimit ka luajtur rolin e një shkolle për bartjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore shpirtërore;

### **Vlerë shpirtërore**

Përmes Ansamblit janë transmetuar njohuritë dhe aftësitë midis brezave duke u ofruar komuniteteve ndjenjën e identitetit dhe të vazhdimësisë.

Andaj, nga kjo që u tha si në dispozitivin e këtij vendimi “Ansambli Kulturo - Artistik Bajram Curri” listohet në kategorinë e trashëgimisë shpirtërore me status të mbrojtjes së përkohshme.

*Vendimi i dërgohet:*

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit Shqyrtues;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK -Prishtinë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.

